

KAPITULLI 75

NIKELI DHE ARTIKUJT PREJ TIJ

Shënim

1. Në këtë Kapitull shprehjet e mëposhtme kanë kuptimin bashkangjitur atyre:

(a) Shufra dhe shkopinj:

Produkte të petëzuara, të stampuara, të tërhequra apo të farkëtuara, jo në spirale, të cilët kanë një seksion kryq solid uniform gjatë gjithë gjatësisë së tyre në formë rrethore, ovale, drejtkëndëshe (përfshirë katrorin), trekëndëshat baras brinjor apo të shumëkëndëshave të rregullt konveks (përfshirë "rrethet e dystuar" dhe "drejtkëndëshat e modifikuar", prej të cilave dy anët e kundërta janë harqe konvekse, dy anët e tjera janë të drejta, të gjatësive të barabarta dhe paralele). Produktet më seksion kryq drejtkëndësh (përfshirë edhe katrorin), trekëndësh apo shumëkëndësh mund të kenë qoshe të rrumbullakosura gjatë gjithë gjatësisë së tyre. Trashësia e produkteve të tilla të cilët kanë një seksion kryq drejtkëndësh (përfshirë "drejtkëndëshat e modifikuar") e kalon një të dhjetën e gjerësisë. Shprehja gjithashtu përfshin produktet e derdhura apo të shkrira, të formave dhe dimensioneve të njëjta, të cilët janë punuar vazhdimisht pas përpunimit (ndryshe nga thjesht zbukurim apo heqje të bigorit), me kusht që ato si rrjedhim nuk marrin karakterin e artikujve apo të produkteve të krerëve të tjerë.

(b) Profilët:

Produkte të petëzuara, të stampuara, të tërhequra, të farkëtuara apo të formuara, në spirale apo jo, të një seksioni kryq uniform gjatë gjithë gjatësisë së tyre, i cili nuk përputhet me ndonjë nga përcaktimet e shufrave, shkopinjve, tela, pllaka, fleta, shirita, krisafe, tuba dhe pipa. Shprehja gjithashtu përfshin edhe produktet e derdhura apo të shkrira, të formave të njëjta, të cilët kanë qenë vazhdimisht të punuara pas përpunimit (ndryshe nga thjesht zbukurimi apo heqja e bigorit), me kusht që ato nuk marrin karakterin e artikujve apo produkteve të krerëve tjerë.

(c) Tela:

Produkte të petëzuara, të stampuara apo të tërhequra, në spirale, të cilët kanë një seksion kryq uniform gjatë gjithë gjatësisë së tyre në formë rrethore, ovale, drejtkëndëshe (përfshirë katrorin), trekëndëshat baras brinjor apo të shumëkëndëshave të rregullt konveks (përfshirë "rrethet e dystuar" dhe "drejtkëndëshave të modifikuar", prej të cilëve dy anët e kundërta janë harqe konvekse, dy anët e tjera janë të drejta, të gjatësive të barabarta dhe paralele). Produktet me seksion kryq drejtkëndësh (përfshirë katrorin), trekëndësh apo shumëkëndësh mund të kenë qoshe të rrumbullakosura gjatë gjithë gjatësisë së tyre. Trashësia e produkteve të tilla të cilët kanë një seksion kryq drejtkëndësh (përfshirë "drejtkëndëshin e modifikuar") i kalon një të dhjetat e gjerësisë.

(d) Pllaka, fleta, shirita dhe krisafe:

Produkte me sipërfaqe të sheshtë (përveçse produkteve të papërpunuara të kreut 7502), në spirale ose jo, të një seksioni kryq solide drejtkëndëshe (përveçse katrore) me ose pa qoshe të rrumbullakosura (përfshirë "drejtkëndëshat e modifikuar" prej të cilit dy anët e kundërta janë harqe konvekse, dy anët e tjera janë të drejta, të gjatësive të barabarta dhe paralele) të një trashësie uniforme, të cilët janë:

- të formës drejtkëndëshe (përfshirë katrorin) me trashësi jo më tepër se një të dhjetën e gjerësisë,
- të një formë ndryshe nga drejtkëndëshe apo katrorë, të çdo përmasë, me kusht që ato nuk marrin karakterin e artikujve apo produkteve të krerëve të tjerë.

Kreu 7506 dhe 7607 zbatohet *ndër të tjera*, për pllakat, fletat, shiritat dhe krisafet me struktura (p.sh., brazda, flanaxha, katrore, çarje, butona, rombe) dhe për të tillë produkte të cilët janë perforuar, korruguar, lustruar apo veshur, me kusht që ato si rrjedhim nuk marrin karakterin e artikujve apo të produkteve të krerëve të tjerë.

(e) Tuba dhe tubacione:

Produkte të zgavruara, në spirale ose jo, të cilët kanë një seksion kryq uniform vetëm me një zgavër të bashkëngjitur gjatë gjithë gjatësisë së tyre në formë rrethore, ovale, drejtkëndëshe (përfshirë katrorin), trekëndësh baras brinjor apo të shumëkëndëshave të rregullt konveks, dhe të cilët kanë një trashësi uniforme të mureve. Produktet me një seksion kryq drejtkëndësh (përfshirë katrorin), trekëndësh baras brinjor, apo shumëkëndësh të rregullt konveks, të cilët mund të kenë qoshe të rrumbullakosura gjatë gjithë gjatësisë së tyre, do të konsiderohen gjithashtu si tuba dhe tubacione me kusht që seksioni kryq i brendshëm dhe i jashtëm janë barazqendror dhe kanë të njejtën formë dhe orientim. Tubat dhe tubacionet e seksioneve kryq të sipërshkuar mund të jenë të lustruara, veshura, përkulura, filetuar, të shpuara, ngushtuara, zgjeruara të dhëna në formë koni apo të përshtatura me flanaxha, kular apo unaza.

Shënim i nën krerëve

1. Në këtë Kapitull shprehjet e mëposhtme kanë kuptimin e dhënë bashkëngjitur atyre:

(a) Nikel, jo i lidhur

Metal që përmban ndaj peshës të paktën 99 % nikel plus kobalt, me kusht që:

- (1) përmbajtja e kobaltit ndaj peshës nuk e kalon 1,5 %, dhe
- (2) përmbajtja ndaj peshës e çdo elementi tjetër nuk e kalon limitin e specifikuar në tabelën e mëposhtme:

Elemente të tjera

Elementi		Përmbajtja limit ndaj peshës në %
Fe	Hekur	0,5
O	Oksigjen	0,4
Elemente të tjera, secila		0,3

(b) Lidhjet e nikelit:

Substanca metalike në të cilat nikeli predominon ndaj peshës mbi çdo nga elementet e tjerë me kusht që:

- (1) përmbajtja ndaj peshës e kobaltit e kalon 1,5 %,
 - (2) përmbajtja ndaj peshës e të paktën njërit prej elementeve të tjera është më e madhe sesa limiti i specifikuar në tabelën e sipërpërmendur, apo
 - (3) përmbajtja totale ndaj peshës e elementeve të tjerë përveçse nikelit plus kobaltin e kalon 1 %.
2. Pavarësisht nga rregullat e Shënimit 1(c) të Kapitullit, për qëllime të nën kreut 7508 10 termi “tela” zbatohet për produktet, nëse janë apo jo në spirale, të çdo seksioni kryq seksional, prej të cilëve asnjë seksion kryq seksional nuk i kalon të 6 mm.

Kodi i mallrave	Përshkrimi	Njësitë plotësuese	Masa të politikës tregtare		Norma të detyrimit (%)	Norma preferenciale të detyrimit (%)	TVSH (%)	Norma të akcizës
			Importi	Eksporti				
						CEFTA / MSA		
7501	Metaline nikeli, aglomerat i oksidit të nikelit dhe produkte të tjera ndërmjetëse në metalurgjinë e nikelit:							
7501 1000 00	- Metaline nikeli	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0	18	-
7501 2000 00	- Aglomerate të oksidit të nikelit dhe produkte të tjera ndërmjetëse në metalurgjinë e nikelit	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0	18	-
7502	Nikel i papërpunuar:							
7502 1000 00	- Nikel, jo i lidhur	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0	18	-
7502 2000 00	- Lidhje të nikelit	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0	18	-
7503 00	Mbetje dhe kthime të nikelit:							
7503 0010 00	- Prej nikeli, jo të lidhur	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0	18	-
7503 0090 00	- Prej lidhjeve të nikelit	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0	18	-
7504 0000 00	Pluhura dhe fetëza të nikelit							
7504 0000 00	Pluhura dhe fetëza të nikelit	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0	18	-
7505	Shufra, shkopinj, profile dhe tela nikeli:							
	- Shufra, shkopinj dhe profile:							
7505 1100 00	-- Prej nikeli, jo të lidhur	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0	18	-
7505 1200 00	-- Prej lidhjeve të nikelit	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0	18	-
	- Tela:							
7505 2100 00	-- Prej nikeli, jo të lidhur	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0	18	-
7505 2200 00	-- Prej lidhjeve të nikelit	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0	18	-
7506	Pllaka, fleta, shirita dhe krisafe nikeli:							
7506 1000 00	- Prej nikeli, jo të lidhur	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0	18	-
7506 2000 00	- Prej lidhjeve të nikelit	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0	18	-

Kodi i mallrave	Përshkrimi	Njësitë plotësuese	Masa të politikës tregtare		Norma të detyrimit (%)	Norma preferenciale të detyrimit (%)	TVSH (%)	Norma të akcizës
			Importi	Eksporti		CEFTA / MSA		
7507	Tuba, tubacione dhe përshtatje të tubave dhe të tubacioneve (p.sh., bashkime, mençe, kthesa) prej nikeli:							
	- Tuba dhe tubacione:							
7507 1100 00	-- Prej nikeli, jo të lidhur	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0	18	-
7507 1200 00	-- Prej lidhjeve të nikelit	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0	18	-
7507 2000 00	- Përshtatje të tubave dhe të tubacioneve	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0	18	-
7508	Artikuj të tjerë prej nikeli:							
7508 1000 00	- Veshje, grilla dhe rrjeta, prej telave të nikelit	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0	18	-
7508 9000 00	- Të tjera	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0	18	-